



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

FTESE PËR NEGOCIATË

Lënda: Ftesë për negociatë për “Prodhimin e një fushate komunikimi për tatimpaguesit në lidhje me zbatimin e ligjit të ri për ‘Tatimin mbi të Ardhurat’”

Të nderuar,

Mbështetur në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi nga organet e Administratës Shtetërore, pika 9, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ju dërgon këtë ftesë për pjesëmarrje për realizimin dhe prodhimin e një fushate komunikimi për informimin e tatimpaguesve në lidhje me zbatimin e ligjit të ri të “Tatimit mbi të Ardhurat”.

Objekti i fushatës: Zhvillimi i një fushate informuese për zbatimin e ligjit të ri nr. 29/2023 të “Tatimit mbi të Ardhurat”, i cili ka hyrë në fuqi nga 1 janari 2024.

Nevoja për kryerjen e reklamave/spoteve: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur informimi/edukimi i tatimpaguesve për veprimet konkrete procedurale dhe ligjore që do duhet të kryejnë në zbatim të ligjit të ri të “Tatimit mbi të Ardhurat”, nga 1 janari 2024.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave: Për informimin mediatik të tatimpaguesve dhe publikut të gjerë lidhur me implementimin e ligjit të ri të “Tatimit mbi të Ardhurat” nga Janari 2024, si nevojë për orientimin/informimin e tatimpaguesve për zbatimin korrekt të ndryshimeve ligjore nga ana e tyre.

Kjo fushatë do të ketë si elementë kryesorë përcjelljen e mesazheve të ligjit të “Tatimit mbi të Ardhurat”, nëpërmjet realizimit të 14 spoteve me tatimatikë si më poshtë vijon:

1 (një) spot-Ligji i ri, Kush përfshihet te Shërbimet profesionale + Përditësimi i kodit të aktivitetit.
1 (një) spot -Ligji i ri, Subjektet që nuk ofrojnë shërbime profesionale me qarkullim deri në 14 milionë lekë.

1 (një) spot -Ligji i ri, Subjektet që nuk ofrojnë shërbime profesionale me qarkullim mbi 14 milionë lekë.

1 (një) spot -Ligji i ri, Përditësimi i kodit ekonomik për tatim të drejtë.

1 (një) spot - Ligji i ri, A do taten bizneset e reja?

- 1 (një) spot - Ligji i ri, Kush deklaron DIVA? Kategoritë.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, Si të regjistrohemi dhe si të plotësojmë DIVA për rezidentët/jorezidentët?
- 1 (një) spot - Ligji i ri, Deklarimi i DIVA 2023-Nuk ndryshon asgjë nga plotësimi i deklaratës.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, Veprimtaritë tregtare, që përfitojnë lehtësi dhe përjashtime tatimore.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, Amortizimi.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, Regjimi i veçantë për individët tregtarë ose të vetëpunësuar.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, DIVA 2024- Ndryshon emërtimi (DVAP); shtohen kategoritë, që e kanë detyrim plotësimin e deklaratës dhe ulet kufiri i deklarimit të të ardhurave personale, nga 2 milionë, bëhet 1.2 milionë lekë.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, ndryshojnë afatet e deklarimit/unifikohet data e deklarimit për deklarata vjetore.
- 1 (një) spot - Ligji i ri, deklarata e statusit personal dhe aplikimi i zbritjes tatimore për TAP.

Specifikimet teknike për prodhimin e 14 reklamave/spoteve informuese janë si më poshtë:

1. Operatori ekonomik duhet të realizojë prodhimin e 14 spoteve në kuadër të fushatës informuese për zbatim e ligjit të ri të “Tatimit mbi të Ardhurat”, i cili ka hyrë në fuqi në 1 janar 2024.
2. Operatori ekonomik duhet të realizojë spotet në ambiente zyresh (me xhirim dhe me grafik 3 dimensional (tabela, statistika etj...), sipas kontekstit të mesazhit apo informacionit sqarues që do të përcjellë spoti.
3. Operatori ekonomik duhet të realizojë spotet me pjesëmarrjen e aktorëve profesionistë (VIP & Influencer) dhe personazhe të animuar për interpretimin e subjektit të reklamës. Gjithashtu, duhet të përdoren titra sqarues të animuar.
4. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër ndërtimin e konceptit, skenarit dhe storyboard-it të spoteve për përcjelljen e mesazhit/informacionit sa më të qartë.
5. Operatori ekonomik duhet të ketë ndricim artistik për planet prespektive.
6. Operatori ekonomik duhet të përdorë muzike me të drejta autori (copyright).
7. Audio dhe kolona zanore e spoteve duhet të jenë cilësore me parametra 4/8khz dhe 24-bit depth.
8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar :
 - Regjisor min 1
 - Videograf min 1
 - Skenarist min 1
 - Fotograf / Drejtor Fotografie min 2
 - Skenograf min 1
 - Kostumograf min 1
 - Grimier min 1
9. Operatori ekonomik duhet të realizojë spotet me zë narratori nga aktorë profesionistë.
10. Operatori ekonomik duhet të ketë ambiente Green Screen për sfonde dhe realizime të vecanta.

11. Eksporti final i produkteve duhet të jetë me formatin 8K ProRes dhe në format digital CD/USB më qëllim shfaqjen e tyre në WEB dhe social media. Gjithashtu, duhet të krijohen nënprodukte të spoteve që lidhen me eksportet dhe përshtatjet në rrjete sociale si : instagram reels, Instagram story, Instagram post, facebook, tiktok dhe youtube.
12. Operatori ekonomik duhet të realizojë fotografi profesionale 2D me personazhet e spotit, për çdo spot.
13. OE duhet të krijojë postera të cilat përmbajnë fotografi, slogan tekst dhe logot e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrisë së Financave.
14. Kohëzgjatja e spoteve duhet të jetë jo më pak se 30 sekonda.
15. Spotet duhet të shoqërohen me sloganin e fushatës, logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrisë së Financave.
16. Operatori ekonomik duhet të ketë eksperiencë në treg jo më pak se 10 vite në fushën e produkteve filmike, reklamave dhe videove promovuese.
17. Operatori ekonomik duhet të zotërojë pajisje të nevojshme për realizimin e produkteve me cilësi të lartë 8K ProRes.
18. Operatori ekonomik duhet të zotërojë kamera profesionale Arri ose Red Camera, si dhe të përdor lente profesionale Zeiss, Lecia ose Cooke.
19. Operatori ekonomik duhet të ketë pajisje që përballojnë montazh mbi 4K.
20. Operatori ekonomik duhet të ofrojë një shërbim profesional në marrjen e audios në terren dhe miksazhit të saj.
21. Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij regjisor profesionist me një eksperiencë minimumi 10 vite në industrinë e prodhimit (i cili do të realizojë spotet).
22. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër realizimin e spoteve të kërkuara nga krijimi i idesë, fabulës, skenarit, gjetjen e personazheve, locationit xhirimit të spoteve dhe eksportit final të produkteve brenda një periudhe 1-mujore nga data e lidhjes së kontratës.
23. Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar për ushtrimin e aktivitetit nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë.

Fondi Limit në dispozicion për prodhimin e 14 reklamave/spoteve si më lart përmendur është 16,666,666 lekë pa TVSH.

❖ **Dokumentet ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKB, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv.
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente.
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar gjatë 3 viteve: 2021-2022-2023.
- Vërtetim për numrin e punonjësve për periudhën Janar 2022-Janar 2023.
- Vetëdeklarim mbi gjendjen gjyqësore, ku shprehet se operatori ekonomik nuk ka ndjekje penale si dhe nuk është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, që lidhet me aktivitetin profesional.

❖ **Dokumentet financiare që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN.
- Kontratë të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (fatura dhe/ose kontrata).
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi.
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës, deklaratën e konfidencialitetit.
- Formularin e ofertës.

Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më lart duhet të jetë i futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj, me mbishkrimin në zarf: “Ofertë për shërbimin”, dhe do të dorëzohet nga përfaqësuesie shoqërive fizikisht pranë protokollit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në datën 01.03.2024, ora 9.30.

Komisioni pret konfirmim nga organet e medias/Agjencive të Specializuara për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociatë.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave të paraqitura, komisioni përzgjedh duke u bazuar në specifikimet teknike, dokumentacionin ligjor dhe financiar të paraqitur nga ofertuesi.

Faleminderit për bashkëpunimin!